



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 703 Prot.

Tiranë, më 02 03 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1032/7 PROT., DATË 17.12.2025 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË
ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA EUROBETON
KONSTRUKSION SH.P.K DHE PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT PA NJË
VENDIM PËRFUNDIMTAR NDAJ ISH GJYQTARIT A. ZH”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga shoqëria “Eurobeton Konstruksion”, me administrator z. Besik Leka, me nr. 1724 prot., datë 24.05.2023, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve F.D., B.M., dhe A.ZH., me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin nr. 1032/7 prot., datë 17.12.2025, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shoqëria Eurobeton Konstruksion sh.p.k dhe përfundimin e verifikimit pa një vendim përfundimtar ndaj ish gjyqtarit A.Zh.”, bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kamëz, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Kamëz, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

